

UNIMARC FONDO UNIVERSALE

Fondo (Astar) i hollueshëm me ujë, Mat

Seri 335

PËRSHKRIMI

Unimarc Fondo Universale është astar (fondo) I hollueshëm me ujë për brenda dhe jashtë, me bazë rrëshire akrilike në tretësire ujore, I përdorshëm në të gjitha rastet kur dëshirohet fuqia mbuluese dhe uniformuese e produktit duke siguruar lidhjen e bojës me sipërfaqen e ljer.

Për t'iu përshtatur sa më mirë destinacioneve të tilla për përdorim, produkti ka një fuqi të shkëlqyer mbushëse, rezulton I lehtë për tu aplikuar me shtrirje të mirë. Filmi I thatë mund të zmerilohet lehtësisht në mënyrë që t'i ofrojë produktit një vendosje solide.

Nga natyra e vet, Unimarc Fondo Universale mund të aplikohet në materiale të ndryshme (dru, sipërfaqe murale, alumin të pagalvanizuar, materiale plastike dhe PVC), edhe për cikle mbrojtëse jashtë.

UDHËZIME PËR PËRDORIMIN

I aplikueshëm brenda dhe jashtë në:

- Sipërfaqe të reja druri, të vjetra dhe të lyera më parë (dyert, skajet e bordeve, trarët, panelet etj).
 - Çdo produkt tjetër që kërkon një ljerje profesionale ose "të bërë vetë".
 - Sipërfaqe alumini të pa galvanizuara dhe në llamarinë të xinguar.
 - Në sipërfaqet e mureve të brendshme, ambiente tregtare, spitale, komunitete.
 - Për materiale plastike dhe PVC.
- Nuk I kalohet shtresë me produkte nitroceluloze ose bojëra që hollohen me nitro.
- KUJDES në trajtimin e drurit të pasur me taninë si lisi, arra, qershia, pisha, bredhi. Për të reduktuar formimin e njollave të errëta aplikoni astarin izolant UNIMARC PRIMER ANTITANNINO me kod 3080001/0019.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Natyra e lidhësit: Kopolimer akrilik me bazë uji
Tretësi: Uji
Dendësia UNI EN ISO 2811-1: $1,33 \pm 0,05$ kg / l.
Viskoziteti UNI 8902: 9000 ± 800 cps në 25°C (viskozimetër rrotullues Brookfield).
Tharje (në 25°C dhe 65% të U.R.): në kontakt pas 2 orësh, ljerja pas 6 orësh.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqet e drurit:

- Zmerilim I lehtë për të hequr fibrat e drurit.
- Heqja e shtresave të ciflosura të bojës së vjetër dhe qërrimin e I sipërfaqeve të lyera.
- Heqja e rrëshirës duke përdorur holluesin e përshtatshëm.
- Stukoni papërsosmëritë me stuko sintetike. Zmeriloni stukimin dhe eliminoni pluhurin.
- Aplikoni në sipërfaqe të thatë dhe të pastruar 2 shtresa Unimarc Fondo Universale.
- Përfundoni ljerjen me një smalt të tretshëm në ujë ose bojë alkide me bazë solventi.

Sipërfaqe suva:

- Sigurohuni që sipërfaqja të jetë tërësisht e thatë dhe plotësisht kompakte me murin. Nëse është nevoja duhet bërë meremetimi I suvasë në vendet që shihet e arsyeshme.
- Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 me kod 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes).
- Hiqni, me furçë ose me larje direkte, pluhurat prezente të bojës së vjetër.
- Hiqni pluhurin, smogun dhe të tjerë, me furçë.
- Niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtimin e vrimave, çarjeve me TAMSTUCCO 9400006/9410110. Mbyllni plasaritjet me ngjitës adekuat.
- Zmeriloni stukimin dhe çarjet me letër zmerile, hiqni pluhurin.
- Kryeni zbutje në suva me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 në bazë të tipologjisë së materialit.
- Në sipërfaqe pjesërisht të prishura aplikohet astari me solventë ISOMARC 4410111 ose

UNIMARC FONDO UNIVERSALE

Fondo (Astar) i hollueshëm me ujë, Mat

Seri 335

astarin e mikronizuar pa solvent (tretës)

ATOMO 8840001.

-Aplikoni në sipërfaqe të thatë dhe të pastër 2 shtresa UNIMARC FONDO UNIVERSALE.

-Përfundoni lyerjen me një smalto të hollueshëm me ujë ose bojë alkide me bazë solventi.

(*Hollimi I astarit dhe sasia që duhet aplikuar varen nga absorbimi I materialit dhe përcaktohen me testet paraprake në materiale specifike. Konsultohuni me skedën përkatëse teknike).

Sipërfaqet e xinguar në alumin ose lidhjet e lehta:

-Largimi i gjurmëve të oksideve nga pastrimi mekanik ose manual.

-Pastrojeni në mënyrë të saktë me solucione alkaline ose hollues.

-Aplikoni në sipërfaqe shumë të thatë dhe pa ndryshk, 2 shtresa Unimarc Fondo Universale.

-Pas të paktën 6 orësh aplikoni produktin përfundimtar.

Sipërfaqet plastike (PVC):

-Zmeriloni lehtë sipërfaqen.

-Pastrojeni materialin.

-Aplikoni 2 shtresa Unimarc Fondo Universale

-Pas të paktën 6 orësh aplikoni produktin përfundimtar.

UDHËZIMET E APLIKIMIT

Kushtet e ambientit dhe materialit:

Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C.

Lagështira relative e ambientit: <75%.

Temperatura e materialit: Min. +5 °C / Max. +35°C. Material I thatë.

Shmangni aplikimin në prani të sipërfaqes së kondensuar ose nën ndikimin direkt të diellit.

Mjetet: pinel, rul dhe furçë.

-Nëse aplikimi do bëhet me penel dhe rul hollojeni me ujë 5-10%

-Nëse aplikimi do bëhet me furçë, hollojeni me ujë 15-20%.

Nr. I shtresave: 2 shtresa.

Shkalla e mbulimit: 4-5 m² /1 me 2 shtresa, në materiale mesatarisht absorbuese.

Pastrimi I mjeteve bëhet me ujë menjëherë pas

përdorimit.

Shtresa e dytë pas 6 orësh me: Smalto të hollueshëm me ujë UNIMARC

Smalto sintetik (GLOBAL LUCIDO ose SATINATO, SINTOLIN, KIRON 70).

NGJYROSJA

Ngjyrosja bëhet përmes sistemit tintometrik Marcromie. Produkti mund të pigmentohet edhe me kolorantët COLORADO seri 548. Në rast të përdorimit të fabrikimeve të ndryshme është e këshillueshme të përzihen midis tyre produktet e ndryshme për të shmangur ndryshime në tonalitete.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e konservimit (ruajtjes): +30 °C

Temperatura minimale e konservimit: +5 °C

Produkti preferohet të përdoret deri në 3 vjet pas datës së prodhimit nëqoftëse është ruajtur në kontejnerët origjinalë të pahapur dhe në kushtet e temperaturës adekuate.

TË DHËNA MBI SIGURINË

Vlera limite BE (Dir. 2004/42/EC)

Cat. A: Bojë opake për mure dhe tavanë të brendshëm (shkëlqim <25@60°) (bazë uji): 75 g/l (2007) / 30 g/l (2010)

Cat. D: Bojë për finiturë dhe veshje të brendshme/jashtme druri dhe metali (bazë uji): 150 g/l (2007) / 130 g/l (2010)

UNIMARC FONDO UNIVERSALE Përmban max: 30 g/l VOC

Produkti nuk kërkon paketim sipas D.L 65 me 14/03/03 me ndryshimet dhe përditësimet e ndodhura Përdoreni produktin sipas rregullave aktuale të shëndetit dhe sigurisë; mos hidhni kutitë e ambalazhit në mjedis pas përdorimit, gjithashtu edhe mbetjet e thata duhen trajtuar si mbeturina të veçanta. Mbajini larg nga fëmijët. Përdoreni në vend të venteluar mirë. Në rast të kontaktit me sytë, lajini menjëherë me ujë të

UNIMARC FONDO UNIVERSALE
Fondo (Astar) i hollueshëm me ujë, Mat
Seri 335

bollshëm. Në rast se gëlltitet, konsultohuni menjëherë me mjekun dhe I tregoni etiketën. Mos I hidhni mbetjet në kanalizime, korsitë e ujit ose në terren. Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e të dhënave të sigurisë.

SPECIFIKIMET

Bojë e tretshme në ujë me bazë opake pa aromë. Aplikimi, në sipërfaqje të parapërgatitur, të bojës së hollueshme me ujë me bazë opaca pa aromë, UNIMARC FONDO UNIVERSALE seria 335, me bazë rrëshirë akrilike që tretet në ujë, në të paktën 2 shtresa në sasinë e përcaktuar nga absorbimi I materialit. Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti I produktit. Skeda e paraqitur anullon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.